



[www.shtetiweb.org](http://www.shtetiweb.org)

**Nr. Publikimit: P-01/2013**

## FORUMI

**Rrugët drejt një Hapësire Ekonomike të Përbashkët Shqipëri - Kosovë**

\*\*\*

Dokumenti Curiaweb  
përgatitur nga ekipi Shtetiweb.org

Forumi u mbajt në periudhën: 1 Shtator 2013 – 30 Nentor 2013

Me moderatorë: Prof. Dr. Adrian Civici, Ibrahim Rexhepi

Mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer

## PËRMBAJTJA

1. Hyrje
2. Përmbledhje e parashtrësës
3. Tregtia Shqipëri-Kosovë, gjenerues zhvillimi apo tregues alarmi
4. Konteksti politik për thellimin e bashkëpunimit dypalësh
5. Konteksti ligjor dhe administrativ i bashkëpunimit dypalësh
6. Pengesat kryesore në bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar midis dy vendeve
7. Hapësirat për thellimin e bashkëpunimit dypalësh
8. Bashkimi Doganor, përfitime dhe kosto
9. Bashkërendim Politik apo Bashkërendim Politikash

Pjesëmarrësit e forumit: Adrian Civici, Ibrahim Rexhepi, Nevila Sokoli, Ardian Hackaj, Pajtim Bello, Rexhep Meidani, Zef Preci, Selami Xhepa, Ilir Ciko, Marin Fino, Shenoll Muharremi, Alban Zogaj, Naim Huruglica, Pranvera Kastrati, Enio Civici, Alban Hashani, Florent Bakija, Irena Gibrizi, Shpend Kursani

Kontributet individuale i gjeni në:

<http://shtetiweb.org/curia/viewforum.php?f=14>

## 1. Hyrje

Parashtrësia e këtij forumi synon ofrimin e kontureve orientuese për një debat të balancuar mes kushteve, mundësive, përfitimeve, kostove dhe aplikimit në praktike të teorive të lirive ekonomike në shkëmbimet ekonomike mes dy vendeve fqinjë.

Nëpërmjet një diskutimi publik dhe profesional, janë analizuar dhe vlerësuar aspekte të ndryshme të bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-Kosovë si dhe janë ofruar skenarët apo rrugët që duhen ndjekur për këtë qëllim.

Hapësira e këtij diskutimi është mjaft e gjerë pasi ajo prek aspektet e zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të nënshkruara deri tani nga dy vendet; vazhdon me programimin e avancimit drejt një Tregu të Përbashkët që do të kërkonte arritje të lëvizjes së lirë të mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitaleve, si dhe përfshin disa alternativa ndaj intensifikimit të mëtejshëm të bashkëpunimit, ku politikat ekonomike të dy vendeve do të konvergjonin.

Debati në këtë forum mbështetet në kontekstin ekzistues ligjor dhe institucional të të dyja vendeve dhe është parë nga këndvështrimi i iniciativave dypalëshe dhe rajonale. Edhe pse në faza të ndryshme sa i takon avancimit të marrëdhënieve me Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) dhe procesit të integritimit të dy vendeve në Bashkimin Evropian, aspekte specifike të kuadrit ligjor të këtyre dy të fundit janë vlerësuar gjerësisht.

Temat që tërhoqën vëmendjen e kontribuesve mund të ndahen si më poshtë:

- Analiza dhe komente mbi evolucionin dhe profilin e marrëdhënieve tregtare mes Kosovës dhe Shqipërisë: këtu vihen në pah ngeçjet pas një fillimi të vrullshëm ku shkëmbimet janë shumëfishuar gjatë një faze të parë për të stagnuar me vonë si dhe struktura e varfër e shkëmbimeve në mallra me vlerë të shtuar të lartë, një tipar tjetër që karakterizon flukset aktuale mes dy vendeve. Kjo pjesë është kompletuar me të dhëna statistikore zyrtare të dy vendeve. Duhet të theksohet që rritja dhe diversifikimi i prodhimit vendor në të dy vendet është parakusht për rritjen e shkëmbimeve tregtare mes tyre;
- Analizat mbi komplementaritetin ekonomik mes dy vendeve dhe mbi sektorët dhe aktoret me të rëndësishëm për shkëmbimet mes tyre përbëjnë pjesën e dytë. Rëndësia e rritjes së shkëmbimeve të prodhimeve bujqësore, sinergjitë në prodhimin e energjisë dhe të transmetimit të saj, ngjashmëritë në sektorin energjetik (humbjet në shpërndarje; arkëtimi i ulet, eficaenca e ulet dhe nevoja për një plan veprimi të harmonizuar); bashkëpunimi në zbulimin dhe shfrytëzimin e pasurive minerale në zonat kufitare, etj janë vektorët kryesorë të një bashkëpunimi në rritje mes dy vendeve. Përmendet gjithashtu si mundësi optimale dhe afrimi i diasporës shqiptare si mbajtës të know-how teknologjike dhe të fuqisë financiare;
- Aplikimi më i mirë i masave ekzistuese administrative dhe legjislativ si dhe shfrytëzimi optimal i kuadrit aktual rregullator dhe legjislativ është një nga përfundimet me të rëndësishme të këtij diskutimi. Shumë kontribues ngrenë problemin e një marrëveshje CEFTA të pa-aplikuar në tërësinë e saj. Fërkimet e fundit si pasoje e aplikimeve të barrierave jo-tarifore mes dy vendeve (si rasti i aflatoksinës, çimentos apo dhe i patates) pasqyrojnë reminishencat e politikave kombëtare tregtare të bazuara në interesa të ngushta, në zbatim të shtrembëruar të rregullave dhe janë shpeshherë presion i lobeve të ndryshme kombëtare. Për të evituar barrierat jo-tarifore paraqitet nevoja për avancime ligjore & tekste rregullatore të përbashkëta ose të harmonizuara që trajtojnë problematikën e shkëmbimeve e deri tek koordinimi i drejtësisë dhe i legjislationit ekonomik përkatës mes dy vendeve. Po ashtu institucionet që mbulojnë shkëmbimet duhet të rrisin bashkëpunimin për të rritur eficaencën nga ku disa kontribues përmendin nevojën për unifikime të procedurave të administratave doganore kombëtare dhe nevojën për infrastrukture kufitare lehtësuese për shkëmbimet;

- Roli shume i rëndësishëm i historisë dhe politikës në të dy vendet dhe e ardhmja e tyre e përbashkët në Bashkimin Evropian përmbyllin grupin e temave madhore të trajtuara në këtë forum. Kontribuesit përmendin edhe parametrat kushtëzues socio-ekonomikë, gjithnjë duke i dhënë hapësire realiteteve të shekullit të XXI. *“Bashkëpunimi është një proces global / historik”* por *“Bashkimi doganor duhet të behet vetëm në kuadër të BE”* janë dy linjat drejtuese të debatit. Roli i faktorit politik është parësor në këtë proces, por duhet plotësuar me masat administrative dhe kompletuar me politikat përkatëse. Bashkërendimi strategjik mund të fillojë nga harmonizimi i politikave fiskale, unifikimi i politikave tregtare, përshtatje të ligjit për investimet e huaja mes dy vendeve; harmonizimi i prokurimeve publike; ndërtimin e planeve të përbashkëta për zhvillimin ekonomik dhe integrimin duke filluar nga 2014 – 2020; negociimi i përbashkët me të tretët si p.sh. OBT, etj.

Në pjesën e dytë të Dokumentit Curiweb do të paraqiten kontributet dhe temat e trajtuara më në detaj dhe të grupuara si më sipër. Diskutimet e pjesëmarrësve janë ilustruar ku ka qenë e mundur dhe me statistikat me të fundit të shkëmbimeve si dhe me paraqitje grafike.

## 2. Përmbledhje e parashtrës Curiaweb

Bashkëpunimi ekonomik Shqipëri – Kosovë gjatë dekadës së fundit ka njohur rritje konstante. Por bilanci i tyre tregtar vuan nga një deficit strukturor shumë i lartë, me eksporte anemike kryesisht në lëndë të para me vlerë të shtuar të ulët, dhe importe që mbulojnë deri dhe produktet bazë që historikisht janë prodhuar në vend në mase të madhe. Bilanci i pagesave ekuilibrohet nga remitancat dhe kohët e fundit në Shqipëri, nga borxh marrja. Investimet e huaja janë në rënie si në Shqipëri dhe në Kosovë.

Të dyja vendet karakterizohen nga një rritje ekonomike relativisht e lartë, e shoqëruar me një inflacion të mbajtur nën kontroll. Në 2012, në Kosovë operonin 502 biznese shqiptare, kryesisht në ndërtim dhe financë, ndërsa në Shqipëri 386 biznese kosovare, kryesisht mikro dhe të vogla. Në shkëmbimet tregtare, dominojnë metalet ku Kosova eksporton hekur mbeturinë (skrap), si edhe një sasi të vogël të gypave të çeliktë, ndërsa importon hekur për ndërtim. Importi i Shqipërisë nga Kosova zë afërsisht 1 % të importit të saj total, ndërsa eksporti zë afërsisht 8,15 % të totalit. Kurse për Kosovën importi nga Shqipëria zë afërsisht 3,9 % të totalit të saj të importit, ndërsa eksporti zë afërsisht 10,8 % të totalit. Shumë e rëndësishme është dhe praktika e shkëmbimit në sektorin energjetikës.

Në kontekstin fiskal diferencat midis vendeve përfaqësojnë dallimin mes shkallës së TVSH së aplikuar (në Shqipëri është 20% dhe në Kosovë 16%) dhe bazën e taksueshme. Sa i takon Tatimit mbi Fitimin dhe mbi të Ardhurat, deri në 31 dhjetor 2013 dallimi ishte mes formulës unike 10% në Shqipëri, dhe asaj gjysmë-progresive në funksion të tavanit, që aplikohet në Kosovë. Që nga 1 janari 2014 Shqipëria ka një paketë të re fiskale që promovon taksën progresive. Në këtë rast sistemi fiskal bëhet edhe më shumë i diferencuar midis dy vendeve.

Që nga viti 2000 marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve janë rritur ndjeshëm si në volumin e shkëmbimeve tregtare, ashtu dhe në harmonizimin e kontekstit rregullator. Që nga tetori 2003 Shqipëria dhe Kosova liberalizuan konsiderueshëm tregtinë midis tyre, për të arritur në 2007, me hyrjen në të CEFTA, në liberalizim të plotë të tregtisë dypalëshe. Megjithatë inter-penetrimi ekonomik mes tyre mbetet relativisht i ulët në krahasim me mundësitë dhe nevojat e ekonomive respektive. Kjo situatë është si rezultat ndër të tjera edhe i aplikimit të pengesave jo-tarifore, si p.sh., në rastet e patates, të çimentos, të qumështit, të mishit, etj.

Idetë dhe hapat e hedhura për ngritjen e Hapësirës Ekonomike të Përbashkët Shqipëri – Kosovë, në kuadrin e një bashkëpunimi rajonal më të thellë, janë të shumta. Diskutimi rreth tyre po bëhet gjithmonë e më i pranishëm në qarqet akademike dhe në politikë-bërjen e të dy vendeve. Në këtë forum janë parashtruar tri skenarë të mundshëm për bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe Kosovës.

- Zbatimi i marrëveshjeve të nënshkruara deri tani midis dy vendeve, kryesisht për themelimin dhe funksionimin e një Zone të Tregtisë së Lire (ZTL);
- Krijimi i një Bashkimi Doganor (BD);
- Intensifikimi i mëtejshëm i bashkëpunimit bilateral drejt një Tregu të Përbashkët (TP).

Është e rëndësishme të theksohet që këto synime nuk përjashtojnë njëra-tjetrën por mund të ekzistojnë të ndërthurura në shkallë të ndryshme, brenda Hapësirës Ekonomike të Përbashkët. Po ashtu ato nuk janë sekuenciale d.m.th. elementë të BD mund të vihen në jetë në kuadrin e funksionimit të një ZTL, etj.

Skenarët e forcimit dhe të optimizimit të marrëdhënieve ekonomike mes dy vendeve të propozuara për diskutim në këtë forum janë si më poshtë:

---

<sup>1</sup> Për ndryshime nga sektorët e tjerë, në energjetikë ka pak eksport dhe import klasik, meqenëse kryesisht bëhet fjalë shkëmbimin e energjisë elektrike (huazimin) në monetet kur sistemet energjetike kanë tepriçë të prodhimit. Që nga viti 2001 e deri në fund të vitit 2012 Kosova nga Shqipëria ka marrë 947.631 megavat orë energji elektrike, ndërsa ka dhënë 1.199.755 megavat orë. Ndërkaq, si blerje klasike ka realizuar vetëm 66,9 mijë megavat orë.

*Skenari i parë:* Aplikimi optimal dhe përmirësimi i funksionimit të marrëveshjeve ekzistuese. Më të rëndësishmet janë dy, (i) CEFTA, e cila është në fuqi për të dyja vendet që nga korriku 2007 dhe (ii) Protokollin e Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar për Bashkëpunimin Shqipëri - Kosovë për bashkërendim politikash i firmosur në vitin 2012.

Në kuptimin e liberalizimit të shkëmbimit të mallrave midis Kosovës dhe Shqipërisë, CEFTA ka ezuaruar të gjitha hapësirat ligjore dhe rregullatore, por në kuptim të lehtësimit real të tregtisë dhe eliminimit të barrierave jo-tarifore ka akoma shumë për të bërë. Shqipëria dhe Kosova kanë krijuar zonën e tregtisë së lirë që në vitin 2007 por kjo lejon vetëm lëvizjen e lirë të mallrave, e cila duhet thënë se akoma nuk e ka sjellë nivelin e tregtisë midis dy vendeve tona në potencialin e vet të mundshëm. Ankesat e eksportuesve nga të dy vendet kanë të bëjnë me aplikimin nga administratat kombëtare të rregullave të ndryshme fitosanitare, me rregulloret kombëtare administrative të zhdoganimit, me ndryshimet e shpeshta dhe normat penalizuese të çmimeve të referencës, etj.

Gjithashtu, janë përgatitur edhe marrëveshje të tjera për tu nënshkruar mes dy vendeve, p.sh. marrëveshja për nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë, të cilat do të kontribuojnë në intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare.

*Skenari i dytë:* Krijimi i një bashkimi doganor midis dy vendeve do të karakterizohej nga (i) vendosja e një sistemi tarifash doganore të përbashkët me vendet e treta pavarësisht rregullit të origjinës, (ii) eliminimi i pengesave teknike ndaj shkëmbimeve nëpërmjet harmonizimit dhe unifikimit të normave teknike në të dy vendet, (iii) negociim të përbashkët për aspektet e tregtisë me vendet e treta apo institucionet ndërkombëtare si OBT, (iv) qarkullimi i lirë i faktorëve të prodhimit mes dy vendeve, (v) rritja e bashkëpunimit ndër-kufitar në sektorë të ndjeshëm si lufta kundër krimit financiar, infrastruktura lokale, etj. Këto zhvillime do të kërkonin një shkallë koordinimi dhe vazhdueshmërie me të lartë mes dy vendeve, gjë që do të bënte të nevojshme ngritjen dhe funksionimin e një administrate të përbashkët me rregullat, kompetencat dhe kostot e veta.

*Skenari i tretë:* Intensifikimi i mëtejshëm i bashkëpunimit bilateral drejt krijimit të një Tregu të Përbashkët me politika ekonomike të përbashkëta do të zhvillonte më tej bashkëpunimin ekonomik të arritur nga Bashkimi Doganor. Disa nga politikat sektoriale strategjike ku bashkërendimi dhe konvergjenca do të përktheheshin në një proces vendim-marrje unik, do të ishin: (i) vlerësimi i mundësive të çdo vendi prodhues dhe i kërkesës me qëllim bashkërendimin dhe promovimin e shkëmbimeve të ndërsjella; (ii) politika e koordinuar e transportit (detar / rrugor / hekurudhor), ku përveç veprave "patriotike" madhore si Rruga së Kombit, dhe të pikave hyrëse dhe dalje në Shëngjin, Durrës, Merdare ose Leposaviq rol të veçantë zë dhe krijimi i korridoreve shtesë në zonat ndër-kufitare; (iii) politika energjetike, e fokusuar në bashkërendimin e investimeve të përbashkëta, në prodhim, transmetim, depozitim, prokurim, diversifikim të burimeve energjetike dhe shkëmbim të energjisë; (iv) politikat e mbrojtjes së konsumatorit, nëpërmjet harmonizimit, unifikimit dhe njohjes reciproke të kompetencave të organeve nacionale, procedurave, rregulloreve dhe teknologjive të përdorura në secilin vend; (v) politika e turizmit përmes harmonizimit të ofertës dhe produkteve turistike cilësore; (vi) hartimi dhe zbatimi i iniciativave të përbashkëta për përmirësimin e klimës së biznesit, (vii) koordinimi i politikave dhe strategjive makroekonomike, fiskale e buxhetore për të krijuar një zonë ekonomiko-financiare të përbashkët, etj.

Çështjet e propozuara për diskutim në këtë forum përmbledhin avantazhet e pashfrytëzuara nga mos-eliminimi i pengesave jo-tarifore, listojnë disa nga pengesat ekzistuese, nxjerrin avantazhet e formave të ndryshme të bashkëpunimit, si dhe identifikojnë sektorët dhe aktorët më të prirur për një bashkëpunim në rritje.

Kontribuesit e këtij forumi ndajnë ide, mendime dhe qasje të ndryshme sa i takon hapave që duhet të ndjekë thellimi i bashkëpunimit midis dy vendeve. Gjithsesi çfarë i bashkon të gjithë kontribuesit e forumit është nevoja për politika të përbashkëta, pavarësisht nëse nëpërmjet një bashkimi Doganor apo Tregu të Përbashkët, të cilat lejojnë sinergji dhe krijojnë mundësi më të mira ekonomike për qytetarët e të dy vendeve.


### 3. Tregtia Shqipëri-Kosovë, gjenerues zhvillimi apo tregues alarmi

Sa paraqitur nga moderatorët, Shqipëria dhe Kosova nuk janë reciprokisht njësoj të rëndësishëm në tregtinë midis tyre. Të dhënat zyrtar të Shqipërisë tregojnë se për vitin 2012 volumi tregtar i shkëmbimeve me Kosovën arriti 160.5 milion Euro me një raport 35.8 milion Euro importe, ose 1% e totalit të importit të Shqipërisë, dhe 124,7 milion Euro eksporte ose 8.15% e eksporteve totale të Shqipërisë.

Mallrat kryesore të importuara nga Kosova gjatë 2012 janë kthime dhe mbetje hekuri, miell gruri dhe meslini, zhavorr, gurët e thyer apo të shtypur, patate, ujëra dhe limonada, etj. Eksporti shqiptar drejt Kosovës dominohet nga çimento, tulla ndërtuese qeramike, shufra e shkopinj gize dhe çeliku, xeherorë e koncentrate hekuri dhe kromi, etj.

Gjatë 10 mujorit 2013 volumi i shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve është rritur me avantazh për Kosovën. Importet janë rritur me 26% ndaj së njëjtës periudhë të vitit 2012 ndërsa eksportet janë rritur me 3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012.

**Grafiku 1. Import-eksporti i Shqipërisë me Kosovën, në % ndaj totalit**




Viti 2013, 10 mujor

Burimi i të dhënave, INSTAT

Ndërkohë, sipas raporteve zyrtare të Institutit të Statistikave të Kosovës, në korrik 2013, Shqipëria është destinacioni i dytë më i rëndësishëm për eksportet kosovare me 15% të tregut, ndërsa radhitet e nënta për importet, me vetëm 5.3%. Gjithësesi të dhënat tregojnë paqëndrueshmëri, sipas grafikut 2 më poshtë.

**Grafiku 2. Import-Eksporti i Kosovës me Shqipërinë, në 000 Euro**



Burimi i të dhënave, INSTAT


Struktura e produkteve të shkëmbyera reciprokisht midis dy vendeve është e varfër (Haçkaj), dhe ndodhet në brezin e “vlere të shtuar të ulët” (Kastrati), duke përbërë një handikap

krahasuar me potencialet reale të dy vendeve. Po ashtu orientimi i tregtisë se jashtme për Shqipërinë dhe Kosovën është krejtësisht i ndryshëm. Si pasojë e zhvillimeve historike, për Kosovën shkëmbimet (kryesisht importet) janë të orientuara më shumë drejt Serbisë (*Hashani*) dhe Maqedonisë, ngaqë sistemi prodhues i Kosovës dhe profili i konsumit të vendit kanë qenë pjesë përbërëse e zinxhirit prodhues dhe shpërndarës të vendeve të ish-Jugosllavisë. Ndërkohë që për Shqipërinë orientimi i tregtisë është drejt vendeve të Bashkimit Evropian (*Kastrati*). Kjo shpjegohet me shkatërrimin e bazës industriale dhe tërë sistemit produktiv me pasojë rrafshimin e aftësive prodhuese tradicionale së bashku me zhdukjen e partnerëve përkatës, dhe krijimin thuaj ex-nihilo të produkteve të reja dhe partnerëve të rinj. Kjo panoramë e ndryshme e orientimit tregtar të dy vendeve tona kërkon domosdoshmërisht që të zhvillohen hulumtime të thelluara për të identifikuar avantazhet konkurruese të dy vendeve në shekullin e XXI dhe mënyrën për ti mbështetur ato (*Hackaj, Ciko*) drejt tregjeve respektive.

Një element tjetër për tu konsideruar në këtë analizë është edhe raporti midis produkteve industriale dhe bujqësore në eksport pasi kjo mund të lejojë identifikimin e sektorëve për të cilët ekonomitë mund të specializohen. Kështu për Shqipërinë, në vitin 2012, ky raport në eksport ishte respektivisht 92,4% dhe 7,6%, çka tregon për një problem serioz të aftësive prodhuese të sektorit të bujqësisë në Shqipëri (*Kastrati*) dhe vë në pah mundësitë reale të Kosovës për tu specializuar më tej.

Nga të dhënat zyrtare të Shqipërisë (INSTAT) vihet re lehtësisht mungesa e theksuar e diversifikimit të eksporteve dhe të importeve. Gjithashtu këto të dhëna tregojnë se Shqipëria dhe Kosova mund të shfrytëzojnë shumë më mirë komplementartetin në sektorin bujqësor, meqenëse janë specializuara në produkte të ndryshme: Shqipëria në produkte industriale ndërsa Kosova në produkte bujqësore të freskëta dhe të përpunuara.


**Grafiku 3: Eksporti me Kosovën, janar-tetor 2013**



Burimi: INSTAT



**Grafiku 4: Importi me Kosovën, janar-tetor 2013**



Burimi: INSTAT

Hashani shkon edhe më tej duke paraqitur tezën që dominimi i strukturës së eksportit nga sektorët primare, me vlerë të ulët të shtuar dhe të dominuar nga lënda e parë dhe mallrat e papërpunuara, tregon njëherazi edhe dobësitë në strukturën prodhuese të ekonomive respektive. Ndërsa *Kursani* thekson se pa prodhim vendor të qenësishëm, shkëmbimet nuk do të sjellin vlerë të shtuar në ekonominë e dy vendeve dhe si pasojë dhe investimet në strukturën thjeshtësuese të shkëmbimeve tregtare do të kenë rentabilitet të ulët. Në këtë optikë sipas *Kursanit*, “Rruga e Kombit” një investim prej EUR 1,6 mld për të dy vendet ka kontribuar më tepër në diversifikimin e burimeve të furnizimit se sa në modifikimin e origjinës së mallrave të importuara. Me pak fjale, Shqipëria ka investuar 1 MID euro për të lehtësuar tranzitin e mallrave që Kosova importon nga vendet e treta. Mungesa e prodhimeve shqiptare të krahasueshme me importet kosovare, e ka ulur kontributin e pritshëm të këtij investimi.

Si ka ndryshuar roli i secilit vend në tabelën e eksporteve të vendit tjetër? Sa e qëndrueshme është tendenca e rritjes së shkëmbimeve? Po të analizojmë rastin e Shqipërisë do të vërejmë se Kosova u bë vendi i dytë më i rëndësishëm për eksportet shqiptare në vitin 2010, vend i cili ka qenë tradicionalisht Greqia (*Kastrati*). Ndërkohë, këtë pozicion në vitin 2012 e ka zënë Spanja, (shiko grafikun 4). Një vështrim më i detajuar mbi këto të dhëna na lë të kuptojmë që kalimi i Spanjës në vend të dytë përcaktohet kryesisht nga eksporti në rritje i një artikulli (në këtë rast janë hidrokarburet). Megjithatë, ndikimi i një artikulli mbi strukturën, destinimin dhe madhësinë e shkëmbimeve të një vendi si Shqipëria tregon qartë dobësinë dhe varfërinë strukturore dhe në vlerë të eksporteve të vendit.

Ajo që bie në sy në evolucionin e shkëmbimeve mes dy vendeve, është fakti që eksportet e Shqipërisë drejt Kosovës janë rritur por gjithsesi ato nuk janë bërë aq të qëndrueshme sa të vijojnë të ruajnë pozicionin e fituar gjatë periudhës të 2009-2010. Edhe në situata të favorshme teknike dhe administrative si p.sh. mbyllja e kufirit me Serbinë dhe vendosja e barrierave të plota tregtare ndaj Serbisë nga ana e Kosovës, e cila zgjati për 58 ditë në vitin 2011, të dy vendet treguan dobësi të theksuara për sa i takon komplementaritetin dhe integritetin të tyre ekonomik.

Nga të dhënat tregtare të tremujorit të tretë të vitit 2011, periudhë kur u vendos kjo barrierë ndaj Serbisë, shihet se eksportet shqiptare nuk kanë kontribuar gati fare në zëvendësimin e mallrave serbe në Kosovë. Vendet të cilat i zëvendësuan mallrat nga Serbia në nivel më të theksuar ishin Maqedonia dhe Greqia, ndërkaj në një nivel më pak të theksuar ishin dhe Kroacia dhe Bullgaria (*Kursani*).

Grafiku 4: Pese destinacionet kryesorë të eksporteve te Shqipërisë

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Gjermania	2.5%	2.7%	3.4%	3%	2.9%	3.1%	4.4%
Greqia	8.4%	8.9%	7.4%	5.5%	5.1%	4.4%	3.2%
Hollanda	0.1%	1.4%	0.6%	0.7%	0.7%	1.0%	0.6%
Italia	67.9%	61.7%	62.3%	51.0%	53.2%	51.0%	46.6%
Kina	2.6%	2.8%	4.7%	5.5%	2.5%	2.7%	4.8%
Kosova	4.8%	6.5%	6.9%	6.2%	7.6%	8.1%	6.9%
Mal i Zi	0.4%	2.1%	1.3%	0.9%	0.9%	0.8%	1.3%
Malta	0.0%	0.0%	0.0%	0.8%	2.4%	1.8%	5.6%
Maqedonia	2.4%	2.9%	3.0%	1.6%	2.1%	1.9%	1.9%
Spanja	0.2%	0.2%	1.2%	3.5%	3.5%	9.2%	11.1%
Turqia	2.2%	1.9%	0.5%	5.7%	7.6%	6.4%	2.6%

Shenim: Viti 2013 eshte 10 mujor

Burimi: Drejtoria e Pergjithsme e Doganave

I pari	
I dyti	
I treti	
I katerti	
I pesti	

Siç u përmend dhe me sipër, mungesa e kapaciteteve prodhuese në të dy vendet kushtëzon dhe kufizon përfitimet nga liberalizimi i shkëmbimeve tregtare për prodhuesit vendore. Nga ana tjetër, janë konsumatorët e Shqipërisë dhe Kosovës që marrin përfitimet e uljes ose të eliminimit të tarifave doganore dhe jo-doganore nëpërmjet zëvendësimit të produkteve vendore të shtrenjta ose përfitimin nga produkte që nuk prodhohen në vend.

Një vështrim i thjeshtë i të dhënave tregtare të rajonit, tregon se produktet serbe u zëvendësuan nga vendet që as nuk kufizohen me Kosovën, duke hedhur poshtë edhe teorinë ekonomike që tregojnë një korrelacion të drejtë midis shkëmbimeve tregtare dhe afërsisë gjeografike të tregjeve.

Në përfundim, nga sa paraqitur më lart mund të thuhet se:

- Shkëmbimet tregtare midis dy vendeve kanë njohur rritje thelbësore që nga viti 2006,
- Struktura e import-eksportit vazhdon të jetë anemike, e pa diversifikuar, dominuar nga produkte primare me vlerë të ulët të shtuar,
- Tregtia midis Shqipërisë dhe Kosovës ka hapësira të mëdha për tu bërë komplementare, në produktet ku secili vend ka avantazh konkurrues dhe si pasojë, në prodhimin e të cilit duhet të specializohet.

Në këtë kontekst, shkëmbimet aktuale tregtare duhet të ishin një gjenerator i funksionimit më të mirë të tregjeve tona drejt një integrimi me qenësor. Në realitet mungesa e aftësive prodhuese vendore, struktura e varfër e shkëmbimeve, vlera e shtuar e ulët e mallrave për eksport janë tregues alarmi për politikanet e të dy vendeve dhe vënë në pikëpyetje dhe vetë logjikën e një hapjeje tregu në të dyja vendet të pashoqëruar me masa mbështetëse dhe mbrojtëse përkundëjt kapaciteteve prodhuese vendore. Hapja e kufijve për shkëmbime tregtare mes Shqipërisë dhe Kosovës duke hequr barrierat tarifore është e nevojshme por jo e mjaftueshme dhe bën të nevojshëm një koordinim mes vendeve përtej politikave thjesht tregtare.

#### 4. Konteksti politik për thellimin e bashkëpunimit dypalësh

Historia dhe realiteti i ekonomisë botërore dëshmojnë se mësimet, si ato pozitive ashtu dhe dështimet e angazhimeve në tregtinë preferenciale midis dy apo më shumë vendeve, në thelb janë të motivuara nga faktorë kryesisht jo-ekonomike ku rolin parësor e kanë çështjet politike, ato të nevojës së krijimit të stabilitetit në një rajon të trazuar (Ciko).

Vullneti politik për bashkëpunim nga të dyja anët e kufirit nuk mungon (Meidani, Bakija, Muharremi). Konteksti i bashkëpunimit cilësohet naturshëm pozitiv, bile dhe i detyrueshëm në shërbim të interesave mbarë kombëtare por që " ...duhet zhvilluar e përpunuar më tej në gjitha drejtimet... çdo rezultat pozitiv ndërveprues, i shërben jo vetëm fuqizimit të zërit shqiptar në rajon e botë, por dhe zhvillimit të gjithanshëm mbarëkombëtar, vetë procesit të mirëfilltë të bashkimit kombëtar, që nëpërmjet integritetit evropian, mund të arrijë të sendërtojë edhe cilësi të reja territoriale vetë-integruese" (Meidani). Në këtë optikë, bashkëpunimi ekonomik është vetëm një aspekt i bashkërendimit të gjithanshëm mes shteteve shqiptare që duhet të përfshijë një fushe me te gjere dhe jo vetëm ekonomike.

Duke e rivendosur debatin në lëmin e shkëmbimeve ekonomike, *Hackaj* paraqet avantazhet e një bashkëpunimi në rritje mes dy vendeve si të justifikuar kryesisht nga ana ekonomike – ulje kostosh dhe çmimesh, luftim monopolesh, rritje e konkurrencës, thjeshtim procedurash administrative, rritje e tregut, etj. Politikisht intensifikimi i bashkëpunimit sjell kosto administrative, financiare dhe politike në formën e ndarjes së kompetencave të ligjvënësve dhe të vendimmarrësve nacionale me homologët e vendit tjetër. Në rastin e avancimit drejt një Bashkimi Doganor kaq të përmendur mes Shqipërisë dhe Kosovës, nevojitet një angazhim politik me substancial, e për rrjedhojë lind një kosto me e larte përkundrejt Zonës së Tregtisë së Lire. ZTL si një formë më e lehtë organizimi, kërkon vetëm një sekretariat për monitorim dhe mbështetje administrative dhe një forum për dialog mes palëve.

Në këtë optikë përmendet dhe ideja e krijimit të një Benelux-i Ballkanik (*Sokoli*) që do të krijonte një treg të përbashkët ekonomik mes 4 vendeve anëtare, Shqipëri, Mal i Zi, Kosovë dhe Maqedoni. Gjithësesi, secili nga këto shtete është relativisht i vogël dhe prodhimi i tyre është i kufizuar, ndaj dhe kompanitë e mëdha ndërkombëtare do të preferonin një treg Ballkanik unik, me qarkullim dhe prodhim në një hapësirë me një popullsi të konsiderueshme. Duke e zhvilluar më tej këtë qasje, *Bakija* mbështet promovimin e katër lirive mbi të cilat është ndërtuar dhe Tregu i Përbashkët Evropian si arsye për të forcuar bashkëpunimin institucional Kosovë-Shqipëri për jo me pak se një union ekonomik në mes dy vendeve.

Por, në një Bashkim Doganor marrëdhëniet mes partnereve janë me komplekse (negocimi i Tarifës së Përbashkët Doganore, ndarja e të ardhurave nga dogana e përbashkët, përfaqësimi i përbashkët në negociatat me të tretet, etj). Po ashtu integrimi ekonomik më i madh shton presionin për harmonizim të kushteve të MTL-ve të tjera ekzistuese dhe të tarifës bazë të Bashkimit Doganor në emëruesin e përbashkët më të ulët, dhe harmonizim më të thellë të shumë politikave kombëtare që në këtë mënyrë u hiqen nga kompetencat qeverive përkatëse (*Kastrati*). Në terma praktike kjo përkon me një dorëzim të sovranitetit kombëtar drejt instancave bilaterale. Për më tepër ZTL është më e favorizuar se BD edhe nga grupet e presionit për arsye të presionit të lobeve kombëtare në favor të mbrojtjes së interesave të tyre aktuale.

Pavarësisht nga retorika kombëtare në favor të një bashkëpunimi mes dy vendeve, bashkëpunimi ekonomik mes dy qeverive ka ngelur deri vonë në nivelin e deklaratave. Porti i Shëngjinit, Turizmi Patriotik, Rruga e Kombit janë disa nga iniciativat e përmendura por të panisura ose të pashfrytëzuara plotësisht. Koncepti i Bashkëpunimit Strategjik është promovuar se fundmi nga qeveria Rama duke e bërë pjesë perberese të programit të saj ekonomik (*Hackaj*). Nevoja e bashkërendimit mes dy qeverive është bërë subjekt përbërës i çdo prononcimi qeveritar, por me se shumti nga Tirana. Pala Kosovare është shprehur kryesisht nëpërmjet deklaratave të Zv. Kryeministrit Pacolli dhe të ministrive që mbahen nga AKR (*Rexhepi, Bakija*)

---

<sup>2</sup> MTL-të parashikojnë (Standstill Clause) që palët të mos rritin tarifën bazë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe si rezultat cdo konsiderim i tarifës bazë nga Bashkimi Doganor në respektim të kësaj dispozite ka gjasa vetëm të reduktohet më tej

shprehur kryesisht ne mbledhje specialistesh, dhe së fundmi nga lajmerimi nga ana e Kryeministrit Thaçi për mbajtjen e mbledhjes së parë mes dy qeverive në Prizren me 11 Janar 2014.

Ndërkohë Protokollin e Komisionit të Përbashkët Ndër-Qeveritar për Bashkëpunimin Shqipëri - Kosovë për bashkërendim politikash mbetet akoma më tepër një deklaratë e dëshirës së mirë se sa një dokument programor. Dokumenti ndërqeveritar i nënshkruar në mars 2013, është hapi i parë konkret që pas nënshkrimit të memorandumit të Mirëkuptimit në 2008. Po dhe ky dokument ravigëzon objektivat e një bashkëpunimi të intensifikuar plurivalent, por nuk mbulon dispozitat ligjore përkatëse, burimet financiare, dhe mbështetjen administrative dhe njerëzore.

Sa i takon Shqipërisë, bashkëpunimi me Kosovën citohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014 -2020, kryesisht në pjesën e politikës së jashtme ndërkohë që ky bashkëpunim duhet të gjente reflektim edhe në pjesë dhe seksione të tjerë të kësaj strategjie. Është e dëshërueshme që të dyja vendet të përfshijnë bashkëpunimin dypalësh në të gjitha planet, programet dhe strategjitë kombëtare. Ky është i vetmi mekanizëm që do të mund të garantonte axhendë të përbashkët veprimesh dhe politikash si dhe do të mundësonte monitorim të vazhdueshëm të bashkëpunimit dypalësh (*Muharremi*).

Gjithsesi është i qarte objektivi i Qeverisë Rama për koordinim dypalësh në rang politikash. Gjatë vitit 2014 ky synim pritet të materializohet duke dhënë specifikime mbi politikat ekonomike të synuara, masat e planifikuara dhe burimet administrative, financiare dhe njerëzore të vëna në dispozicion të këtyre objektivave. Por kjo strategji e materializuar në mbledhjen e parë ndërqeveritare në Prizren, do të jetë e destinuar “... të dështojë nëse mbahet vetëm për shkak të rëndësisë historike, apo për vlerat kulturore të Prizrenit. ... Këtu qëndron edhe përparësia e qasjes së kryeministrit Rama në krahasim me mënyrën e punës së mëhershme” (*Rexhepi*).

Problemet e tjera politike që duhet të tejkalohen për një bashkëpunim frytdhënës mes dy vendeve, janë: (i) zbutja e pasojave nga ulja e të hyrave nga doganat dhe ri-dizajnimi i flukseve të të ardhurave nga një tarifë eventuale e përbashkët, dhe (ii) mënjanimi i presioneve të lobeve të ndryshme kombëtare në funksion të interesave strategjike me të gjera të të dy vendeve (*Rexhepi, Hackaj*). Ndërkohë *Rexhepi* përmend dhe rolin jo-avantazhues të situatës së krizës aktuale që ka kapluar të gjithë rajonin dhe që ka reduktuar shkallën e lirive të vendimmarrjes të dy qeverive.

Nga pikepamja politike, CEFTA paraqet aktualisht një mospërputhje midis kontekstit ligjor dhe realitetit të Kosovës si shtet i pavarur. Palët ligjore të CEFTA, ose të njohur ndryshe në përcaktimet e të drejtës ndërkombëtare “firmosësit” janë Shqipëria dhe UNMIK. Edhe pse UNMIK nuk ka asnjë rol në zbatimin e përcaktimeve të CEFTA, ligjërisht ai është “Palë” e marrëveshjes. Sipas nenit 51 të marrëveshjes çdo palë mund të tërhiqet nga marrëveshja nëpërmjet njoftimit me shkrim. Nëse do të jetë e nevojshme tërheqja nga CEFTA<sup>3</sup> atëherë kjo tërheqje, sipas të drejtës ndërkombëtare, në rastin e Kosovës duhet të bëhet nga UNMIK. Thënë ndryshe çdo marrëveshje me Shqipërinë që do të kërkonte renegociimin e tarifave psh me CEFTA, do të bënte të nevojshëm nënshkrimin e anekseve të marrëveshjes bazë. Në këtë këndvështrim është shumë interesante të vëzhgohet se si Kosova do të negocionte marrëveshje të reja që prekin CEFTA, përfshirë këtu dhe ato me Shqipërinë, si dhe rolin që do të luante administrata aktuale e UNMIK-ut. Me vullnet të mirë politik, nga pikpamja ligjore e vetmja zgjidhje do të ishte ndryshimi i firmosësit nga UNMIK në CEFTA dhe për këtë ekspertët e të drejtës ndërkombëtare në Shqipëri dhe Kosovë duhet të punojnë fort për të gjetur zgjidhjet e nevojshme ligjore.

---

<sup>3</sup> Tërheqja nga CEFTA është e nevojshme vetëm nëse Shqipëria dhe Kosova vendosin të shkojnë drejt Bashkimit Doganor ose Tregut të Përbashkët. Shiko detajet në pikat në vijim

## 5. Konteksti ligjor dhe administrativ i bashkëpunimit dypalësh

Një nga tezat më të theksuara për të karakterizuar bashkëpunimin mes dy vendeve është nevoja për aplikim më të mirë të kontekstit ligjor dhe administrativ ekzistues kryesisht CEFTA (*Ciko, Hackaj, Kastrati, Gribizi, Hashani*). Jashtë klisheve politike, Shqipëria dhe Kosova nuk kanë nevojë të punojnë për të thelluar bashkëpunimin ekonomik për hir të ndërtimit të marrëdhënieve më të qëndrueshme politike, apo për të krijuar konsensusin e gjerë politik, shoqëror dhe kulturor sepse ai ekziston në të dy anët e kufirit shqiptar. Ajo që nevojitet në rastin e bashkëpunimit ekonomik mes Kosovës dhe Shqipërisë, jashtë formave standarde ligjore dhe administrative për një integrim të qëndrueshëm ekonomik midis dy vendeve tona, është analiza faktuale e faktorëve ekonomikë dhe avantazheve plotësuese që dy vendet mund të arrijnë (*Ciko*).

Për më tepër ky kontekst rregullativo-administrativ është tashmë i krijuar dhe i kompletuar nga ndërthurja detyrimeve që lindin nga adoptimi i *acquis communautaire* dhe nënshkrimi i marrëveshjes së CEFTA, dhe bëhet nën perspektivën e rrugëtimit të dy vendeve drejt institucioneve të Bashkimit Evropian (*Bakija*).

Më në detaj, marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës percaktohen ligjërisht nga: (i) Marrëveshja CEFTA, dhe (ii) Protokollin e Bashkëpunimit Ndërqeveritar Shqipëri-Kosovë.

CEFTA. Edhe pse mund të duket paradoksale CEFTA është e vetmja kornizë ligjore që rregullon marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo natyrisht nuk lidhet me mungesën e vullnetit apo dëshirës për të patur një marrëveshje bilaterale midis dy vendeve, por përfitueshmëria ekonomike e të dy vendeve tona është shumë herë më e madhe brenda një marrëveshje shumëpalëshe se sa dypalëshe. Kjo për faktin se CEFTA ka vendosur të njëjtat kushte dhe rregulla për të gjithë anëtarët e vet, gjë e cila nuk mund të jetë e garantuar në të njëjtën mënyrë dhe thellësi nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta dypalëshe. Sidoqoftë avancimet në tregtinë dypalëshe nuk duhet të jenë domosdoshmërisht të njëjta për të gjitha palët e CEFTA.

Duke marrë parasysh rëndësinë e CEFTA, Curiaweb përfiton nga rasti të paraqesë konturet e funksionimit të shkëmbimeve tregtare mes Shqipërisë dhe Kosovës. CEFTA, edhe pse shumëpalëshe është marrëveshja më e plotë që rregullon marrëdhëniet tregtare midis Kosovës dhe Shqipërisë. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje rregullojnë të gjitha aspektet tregtare të bashkëpunimit mes dy vendeve dhe hap dritare edhe për harmonizim të politikave me karakter ekonomik. Ajo ka krijuar tashmë një platformë unike për politikën tregtare dhe bashkëpunimin rajonal në fushën e tregtisë dhe më gjerë duke garantuar: (i) zbatimin dhe orkestrimin e politikave tregtare sipas parimeve dhe rregullave të OBT-së; (ii) eliminimin e çdo diskriminimi fiskal dhe tregtar midis të gjithave vendeve; (iii) liberalizimin e plotë të tregtisë së mallrave mes të gjitha vendeve të rajonit; (iv) hapjen e tregut të prokurimit publik për vendet CEFTA dhe eliminimin e diskriminimit mbi baza nacionalitetit (*Ciko* në kontributin e tij shprehet skeptik ndaj hapjes reale të këtij tregu, i cili ndër të tjera lidhet edhe me shumë aspekte ligjore dhe institucionale në vendet tona); dhe (v) krijimin e platformës për eliminimin e barrierave administrative dhe te panevojshme tregtare me fokus parësor në rregullat teknike, masat sanitare dhe fitosanitare dhe procedurat doganore duke synuar eliminim *ex-post* mos krijimin e tyre *ex-ante*.

CEFTA është nga të paktat marrëveshje tregtare që ofron një shkallë liberalizimi kaq të shpejtë dhe të thellë. Kjo marrëveshje parashikon eliminim të plotë të tarifave doganore për produktet industriale në të gjitha vendet CEFTA që nga 1 janar 2009 (neni 8, pika 2) dhe liberalizim pothuaj të plotë të tregtisë së produkteve bujqësore. Produktet bujqësore shihen nga të gjitha vendet me skepticizëm dhe mbrojtja e këtyre produkteve gjendet rëndom në çdo marrëveshje tregtare. Me përjashtim të marrëdhënieve të krijuara midis dy apo më shumë vendeve në BD

<sup>4</sup> Kosova, megjithëse nuk është anëtare e OBT-së përfiton nga kjo dispozitë sepse garanton mbrojtjen nga praktikat e pandershme tregtare që mund të merren nga vende të caktuara

<sup>5</sup> Shqipëria dhe Kosova, ndryshe nga çdo anëtar tjetër i CEFTA, është me regjim të liberalizuar që me firmosjen e CEFTA. Kjo në fakt duhet të kishte krijuar avantazh ndaj vendeve të tjera. Të dhënat tregtare, siç u paraqitën edhe më lart nuk e tregojnë këtë.

dhe TP, vendet mbrojnë një kategori të caktuar produktesh bujqësore që janë shumë të ndjeshme për një periudhë përgjithësisht të pacaktuar. Aktualisht, liberalizimi i tregtisë së produkteve bujqësore midis Shqipërisë dhe Bosnjë – Hercegovinës është firmosur dhe është në proces ratifikimi ndërsa liberalizimi midis Kosovës me Kroacinë nuk është më i nevojshëm pasi Kroacia është anëtare e Bashkimit Evropian.

CEFTA gjithashtu promovon transparencën në fushën e politikës tregtare dhe të masave tregtare nëpërmjet (i) notifikimit dhe informimit për barrierat tregtare, (ii) krijimit të portalit të CEFTA me fokus parësor informimin e komunitetit të biznesit, (iii) krijimin e bazës së të dhënave për barrierat jo-tarifore.

Pjesë e procesit të hapjes është edhe ai hapjes së tregut të prokurimit publik. Sipas parashikimeve të nenit 35, pika 2 që nga data 1 maj 2010 tregu i prokurimeve publike është krejtësisht i liberalizuar midis palëve të CEFTA. Edhe pse ky angazhim duket të jetë plotësuar pyetja që lind është. Sa reale është hapja e tregut të prokurimeve publike?

***A mundet një kompani kosovare të konkurrojë si e barabartë dhe të fitojë në një tender të zhvilluar në Shqipëri? Po e kundërta a mund të ndodhë?***

*CEFTA përmban klauzola që kërkojnë nga shtetet pjesëmarrëse pikërisht arritjen e një realiteti të tillë përmes hapjes së tregut të prokurimeve publike ndaj njëri tjetrit, ndërkohë që realiteti dëshmon se mjerisht pak është bërë në këtë drejtim, jo vetëm me shtetet e tjera të rajonit, por dhe midis Shqipërisë e Kosovës ku afrimiteti kombëtar, gjeografik, politik apo i çdo lloj dimensionit tjetër, do të duhej të lehtësonte maksimalisht përmbushjen e angazhimeve që qeveritë përkatëse kanë nënshkruar qartazi në një marrëveshje ndërkombëtare mes tyre.*

*A i ka plotësuar Shqipëria angazhimet e mësipërme në kuadër të marrëveshjes CEFTA, për të mundësuar hapjen e tregut të saj ndaj kompanive kosovare apo nga vendet e tjera të rajonit? Përgjigjja e shkurtër do të ishte po, por kjo nuk mjafton. Formalisht p.sh. tregu i prokurimit publik është i hapur për pjesëmarrje të barabartë të kompanive të huaja, përfshirë ato nga Kosova, krahasuar me kompanitë vendase. Në fakt, po të hapë faqen elektronike të prokurimit publik, çdokush, pavarësisht se ku ndodhet në botë, mund të regjistrohet lehtësisht për të marrë pjesë në çdo tender publik të organizuar në Shqipëri, pra vendi ynë nuk paraqet pengesa për pjesëmarrje të kompanive të huaja në këtë fushë të rëndësishme të aktivitetit ekonomik.*

*Por regjistrimi është veçse nisja e procedurës së prokurimit. Problemi i vërtetë që kompanitë (përfshirë shumë syresh nga Shqipëria) hasin, nuk është refuzimi i mundësisë së pjesëmarrjes në prokurimet publike, por specifikimet teknike dhe ekonomike që përcaktohen në tendera, të cilat rëndom anojnë dukshëm për të paracaktuar fituesit dhe de facto përjashtojnë nga mundësia e konkurrimit kompanitë e huaja (sikurse dhe vendase) që të marrin pjesë realisht në tenderimet publike.*

*Ilir Ciko, <http://shtetiweb.org/curia/viewforum.php?f=14>*

Nga pikëpamja administrative, Shqipëria dhe Kosova bashkëpunojnë brenda strukturave të CEFTA si më poshtë:

- Komiteti i Përbashkët, i cili përbëhet nga Ministrat e Tregtisë të vendeve anëtare, mbledhet 1 herë në vit dhe është niveli më i lartë dhe i vetëm vendim-marrës i CEFTA.
- 3 nën komitete në fushat e (i) rregullave teknike dhe barrierave jo-tarifore, (ii) bujqësia dhe masat sanitare e fitosanitare, (iii) dogana dhe rregullat e origjinës. Këto struktura janë krejtësisht teknike dhe propozojnë zgjidhje teknike për Komitetin e Përbashkët
- 3 grupe teknike në fushën e (i) tregtisë së shërbimeve, (ii) rregullave teknike, (iii) menaxhimit të riskut.

Shqetësimet e tyre dypalëshe Shqipëria dhe Kosova i trajtojnë nëpërmjet diskutimeve *ad-hoc* dhe pa nevojën e strukturave të CEFTA. Megjithatë, si pasojë e mos-funksionimit optimal të një bashkëpunimi dypalësh strukturor të përhershëm, problematikat apo pengesat tregtare në përputhje me përcaktimet e CEFTA, janë adresuar edhe në strukturat e CEFTA. Ky ishte p.sh. rasti i vendosjes së taksës prej 35% për çimenton<sup>6</sup>, masë e cila edhe pse e vendosur në respektim me parimin e mos diskriminimit midis vendeve CEFTA dhe u zbatua për të gjitha vendet njësoj, ajo dëmtonte më së shumti industrinë e prodhimit të çimentos në Shqipëri.

Përtej angazhimit në fushën e mallrave, CEFTA ka objektiva ambicioze në liberalizmin e tregtisë së shërbimeve. Në përputhje me nenin 27 të CEFTA palët janë angazhuar në një proces negociimi i cili pritet të fillojë brenda tremujorit të parë 2014. Qëllimi i këtyre negociatave është krijimi i më shumë hapësirave për shërbimet profesionale, sektorët me potenciale zhvillimi, eliminimin e pengesave në fushën e transportit etj. Këto negociata do të jenë në përputhje me nenin V të GATS dhe synojnë të arrijnë një hapje tregu GATS+.

Gjithashtu, CEFTA parashikon trajtim të barabartë të investitorëve të huaj me ata vendas, neni 32, si dhe garanton nivel të njëjtë mbrojtjeje të drejtave të pronësisë

*Protokolli i Bashkëpunimit Ndërqeveritar Shqipëri-Kosovë* i nënshkruar në 15 mars 2013, në Tiranë, ravigjeron objektivat e një bashkëpunimi dypalësh, të intensifikuar dhe shumëdimensional. Ai mbulon fushat kryesore të bashkëpunimit dypalësh por nuk mbulon dispozitat ligjore përkatëse, burimet financiare dhe mbështetjen administrative. Ky protokoll është nënshkruar në mbledhjen e parë të Komisionit të Përbashkët ndërqeveritar për bashkëpunimin Shqipëri-Kosovë, në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit midis dy vendeve tona të nënshkruar më 19 qershor 2008 në Tiranë. Në këtë dokument parashikohet bashkëpunim në disa fusha, si bashkëpunimin politik, ekonomik dhe tregtar, financiar, kulturë dhe arsim dhe në disa sektorë specifikë (transport, bujqësi, mjedis, shëndetësi, miniera, energji, telekomunikacion, etj.)

Mbledhja e radhës e këtij Komisioni do të jetë pas një viti, nderkohë që pyetjet që ngrihen janë të shumta. A janë krijuar grupet e punës sipas fushave të bashkëpunimit të këtij protokoll? A janë hartuar planet e përbashkëta? Si do të garantohet monitorimi i synimeve të këtij protokoll?

Protokolli i Bashkëpunimit Ndërqeveritar Shqipëri-Kosovë është një dokument i rëndësishëm por gjithsesi ai duhet të jetë komplementar me nisma ligjore dhe administrative dhe duhet të konsiderohet si pikënisja e ndryshimeve financiare, ligjore dhe tregtare ndërmjet dy vendeve. Është jetësore që Protokollin të përshpejtojë nënshkrimin e marrëveshjeve të tjera dypalëshe në fushat e interesit të përbashkët, në bashkëpunimin ekonomik-tregtar, teknologjisë, industrisë minerare, pyjeve, ujërave, sigurimeve shoqërore, arsimin, bashkëpunimit në nivel lokal, shkencës, etj. (*Civici E.*)

Përveç marrëveshjes CEFTA dhe Protokollit të Bashkëpunimit Ndërqeveritar Shqipëri-Kosovë, ka edhe *marrëveshje kryesisht sektoriale* dhe memorandume mirëkuptimi të tjera nënshkruara në vite. Edhe pse pa një strategji të mirë-përcaktuar në funksion të optimalizimit të bashkëpunimit mes dy vendeve, institucione qeveritare të ndryshme në Shqipëri dhe Kosovë kanë bashkëpunuar dhe bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme. Këtu mund të përmendim rastet marrëveshjeve dypalëshe midis Bankave Qendrore, Autoriteteve të Konkurrencës, Drejtorive të Përgjithshme të Akreditimit, Drejtorive të Doganave, etj. Është e domosdoshme që këto raste të koordinohen dhe monitorohen në mënyrë të centralizuar, në mënyrë që të jenë pjesë përbërëse e një strategjie gjithëpërfshirëse. Po ashtu përfshirja e tyre në një strategji të vetme do të eliminonte mbivendosjet, humbjet e informacionit dhe do të rriste efikasitetin nëpërmjet sinergjive.

---

<sup>6</sup> Në fund të qershorit 2012 Shqipëria kërkoi mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit të Përbashkët të CEFTA për këtë masë.

### **Marrëveshjet ekzistuese bilaterale në fushën e bashkëpunimit socio-ekonomik mes dy vendeve**

- Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e punësimit dhe çështjeve sociale mes Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të Shqipërisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës;
- Marrëveshja mbi shmangien e Tatimit të Dyfishtë;
- Marrëveshja e bashkëpunimit në terren në lidhje me zbulimin e shkeljeve të ndryshme, por njëkohësisht për të ndihmuar dhe biznesin me procedurat;
- Marrëveshja për Bashkëpunim në Fushën e Arsimimit dhe Shkencës
- Marrëveshja për Bashkëpunim dhe Ndihmë të Ndërsjellët në Çështjet Doganore
- Marrëveshja e bashkëpunimit për ndërtimin e linjës interkonektive 400 kilovatësh Kosovë – Shqipëri, mes Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Shqipërisë

Marrëveshja mbi lehtësimin e Tranzitit Shqipëri-Kosovë është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë në Gusht 2013 dhe në nëntor 2013 nga homologët Kosovare por akoma nuk është nënshkruar (fillim janari 2014) nga Qeveritë përkatëse.

Në përfundim, do të ishte e rekomandueshme që:

1. Objektivat e Protokollit Ndërqeveritar të reflektohen në dokumentet strategjike kombëtare të të dyja vendeve, si pjesë integrale e prioriteteve të politikave sektoriale/ndër-sektoriale dhe matricës së masave zbatuese,
2. Koordinimi i të gjitha aktiviteteve, planeve dhe iniciativave të diskutohet në këtë Komision Ndërqeveritar, të parashikuar nga Protokollit
3. Të krijohen grupe teknike dypalëshe të përhershme sipas fushave dhe sektorëve të ndryshëm.
4. Të organizohet një tryezë e përbashkët vjetore e Qeverive me palët e interesuara për të patur axhenda konverguese.

### **6. Pengesat kryesore në bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar midis dy vendeve**

Siç parashtron *Civici, A*, madhësia e një tregu është një pengesë serioze në zhvillimin e marrëdhënieve të qëndrueshme ekonomike midis dy vendeve. Gjithashtu, madhësia e vogël e tregut ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në thithjen e investimeve të huaja direkte, dhe mbi të gjitha në cilësinë e tyre. Për vende të vogla si Shqipëria, Kosova, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, etj. krijimi i hapësirave më të mëdha të veprimit të aktivitetit ekonomik e financiar, të hapësirave jo vetëm territoriale, por edhe njerëzore, kapitaleve, investimeve, tregtisë, shërbimeve etj. është një domosdoshmëri. Në këtë këndvështrim, edhe ideja e nxitjes së një hapësire të përbashkët ekonomike mes dy ose me shumë vendeve në Ballkan mund të vlerësohet si një hap prej kërkimit të rritjes së rëndësisë dhe frymëmarrjes së sistemit ekonomik e financiar, të tregjeve e shkëmbimeve të të gjitha llojeve për ekonominë shqiptare dhe atë kosovare (*Sokoli*). Larg ideve apo praktikave të nacionalizmit ekonomik e politik, bërja e analizave, studimeve dhe propozimeve konkrete për masa, politika ekonomike, strategji zhvillimi ekonomik, realizim projektsh të përbashkëta, etj. është sensibilizuar më tej jo vetëm nga ky forum (*Hackaj, Rexhepi*) por edhe rrjete të tjera siç është ai i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të dy vendeve.

Shumë herë problemet politike krijojnë barriera të panevojshme tregtare por ka edhe plot raste kur barrierat tregtare prodhojnë edhe prishje të ekuilibrave politikë. Situata më ekstreme e një barriere tregtare në rajonin tonë ishte ajo e krijuar në kufirin Kosovë-Maqedoni kur u mbyll plotësisht për disa ditë duke bllokuar lëvizjen e mallrave si edhe duke penguar njëkohësisht



lëvizjen e lirë të njerëzve përmes kufirit të dy shteteve, duke sjellë si rezultat edhe ashpërsimin e marrëdhënieve politike midis tyre (*Zogaj*). Edhe pse të dyja vendet janë anëtare të CEFTA, situata nuk mundi të parandalohet. Për më tepër, Maqedonia ishte në shkelje të hapur të dispozitave të CEFTA por gjithsesi situata u zgjidh vetëm pas zbatimit të bllokimit të plotë nga Kosova të produkteve nga Maqedonia. Për fat të keq disa herë janë konstatuar situata jo të pëlqyeshme edhe në tregtinë midis Shqipërisë e Kosovës, duke ngritur pikëpyetje mbi dobinë e funksionimit si duhet të marrëveshjes së tregtisë së lirë.

Koncepti i barrierave tregtare është shumë i gjerë dhe do të ishte e nevojshme që të bëhej një vlerësim i detajuar i barrierave tregtare egzistuese midis Shqipërisë dhe Kosovës, studim i cili më pas mund të kthehet në një plan konkret masash. Ky studim do të mbulonte (i) barrierat teknike, si rregullat teknike dhe masat sanitare e fito-sanitare, dhe (ii) barriera jo-teknike si masat mbrojtëse, licencat jo-automatike, kontrolli i çmimeve, barrierat administrative, rregullat e origjinës, etj.

Kontribuesit e forumit ndajnë ide të ndryshme rreth arsyeve të krijimit të barrierave. Sipas *Hashanit*, pengesat aktuale në krijimin e infrastrukturës dhe eliminimin e barrierave jo-tarifore, në rastin më të mirë janë neglizhencë e qeverive respektive. Sipas tij duhen siguruar kushte që incidentet e shpeshta që paraqiten në sektorë të ndryshëm të mos ndodhin duke krijuar kështu kushte për fuqizimin e marrëdhënieve tregtare.

Nuk duhet harruar se shpesh barrierat tregtare vijnë nga ndërhyrja e interesave të ngushta nga të dy anët e kufirit, të cilat shpesh sjellin uljen e totalit të përfitimeve për qytetarët e të dy vendeve (*Hackaj*). Sipas një këndvështrimi tjetër, raportet ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në disa raste janë karakterizuar me "inate" të strukturave qeveritare, i cili e ka shndërruar reciprocitetin në një mekanizëm për përgjigje në stilin "me barriera kundër barrierave" (*Rexhepi*).

Edhe pse marrëdhëniet dypalëshe Shqipëri-Kosovë nuk njohin shumë pengesa të tilla midis tyre, edhe ato pak që janë evidentuar duhet të analizohen me shumë kujdes. Nga tipologjia e pengesave të ndeshura deri tani në tregtinë Shqipëri-Kosovë mund të paraqiten si më poshtë:

a) *Kërkesa të sigurisë në lidhje me produktet*, si në rastin e nivelit të aflatoksinës për qumështin, miellin, etj. Sipas *Dhomës Tregtisë dhe Industrisë Tiranë*, vetëm në sektorin e qumështit, firmat shqiptare vlerësojnë rreth 1 milion euro dëm për shkak të bllokimeve si rezultat i nivelit ligjor të aflatoksinës në dy vendet tona. Kjo situatë duhet kuptuar që vjen si rezultat i kuadrit rregullator të ndryshëm në dy vendet tona, i cili kapërcehet jo vetëm me vullnet të mirë por edhe me punë harmonizuese rregullatore.

b) *Ndërhyrje të shtetit me masa administrative dhe të kontrollit të çmimeve*. Të tilla mund të përmendim vendosjen e çmimeve të referencës në rastin e patates kosovare, ose aplikimin e procedurave doganore në pikën e kalimit të kufirit të Vërmicës. Aplikimi i çmimeve të referencës, ose ndryshe sipas përcaktimeve të OBT-së, të çmimeve minimale bie ndesh me parimin e vlerës së transaksionit dhe është një masë me efekt të drejtpërdrejtë në tregtinë e një produkti të caktuar. Edhe pse çmimet e referencës nuk zbatohen masivisht apo vetëm për produktet e Kosovës eliminimi i tyre është një domosdoshmëri.

Administrata doganore në Kosovë, në kontributin e *Huruglicës*, paraqitet të ketë vepruar plotësisht e pavarur në përcaktimin e vlerësimit të mallrave në import, ndërsa në Shqipëri kjo ka qenë pak më ndryshe, pasi administrata doganore në Shqipëri, shpeshherë ka caktuar të ashtuquajturat "çmime dysheme", me çka ka përcaktuar çmimin minimal me të cilin lejohet importi i mallrave të caktuara edhe nëse pala ka arritur të dëshmojë drejt vlerën reale të mallrave. Kjo nuk duhet kuptuar që administratat doganore duhet të pranojnë gjithçka çka ju ofrohet nga bizneset, por një bashkëpunim me i afërt midis administratave respektive në shkëmbimin e informacionit dhe verifikimin e gjendjes reale mund ti evitojë këto probleme.

c) *Vendosja e masave mbrojtëse në importe*, si p.sh. rasti i çimentos. Vendosja e barrierave të ndryshme në CEFTA edhe pse zbatohet për të gjitha palët njësoj, nuk i prek ata me të njëjtën masë. Megjithatë rasti i çimentos është parë në CEFTA si një mosmarrëveshje bilaterale midis Shqipërisë dhe Kosovës, ai u trajtua në përputhje me përcaktimet e CEFTA.

Anëtarët e CEFTA-s kanë shfrytëzuar raste të ndryshme për të vendosur barriera tarifore dhe jo tarifore ndaj partnereve, kryesisht me qëllim të mbrojtjes së prodhimeve të tyre endogjene, por edhe si rezultat i reciprocitetit që vendosja e barrierave nga një shtet ka nxitur tek shtetet e tjera anëtare. Vendosja e barrierave brenda bllokut të CEFTA-s mundësohet edhe për shkak të fleksibilitetit që ekziston në marrëveshjen e CEFTA-së për ta bërë një gjë të tillë, e që si rezultat pengon tregtinë e mirëfilltë të lirë – që është edhe objekt i kësaj marrëveshje (*Sokoli*). Në të vërtetë, fleksibiliteti i përcaktimeve të CEFTA nuk është shumë i madh. Nëse Kosova do të kishte ndjekur të gjitha përcaktimet e CEFTA, masa ndaj çimentos nuk do të ishte vendosur. Kjo sepse përcaktimet e CEFTA duhen parë si komplementare me përcaktimet e marrëveshjeve të OBT-së (*Kastrati*).

Megjithatë, kjo nuk i ka penguar vendet e CEFTA që në shumë raste të zbatojnë barriera të njëanshme derisa anëtarët i zgjidhin problemet në formë bilaterale. Si rezultat brenda periudhës 2008-2012 ka pasur shumë raste, sidomos me Kosovën, kur shtetet e ndryshme kanë aplikuar barriera të ndryshme, si tarifore, ashtu edhe jo-tarifore, e që jo domosdoshmërisht në secilin aspekt kanë qenë në kundërshtim me marrëveshjen e CEFTA-s (*Sokoli*).

Duhet nënvizuar se vendosja e barrierave jo-tregtare ka vijuar me gjithë angazhimin e qeverive anëtare të CEFTA për nevojën e moszbatimit të barrierave tregtare dhe zbatimin e masave që shqetësojnë më pak funksionimin e CEFTA, siç dhe konfirmuar në mbledhjen e Ministrave të CEFTA në Tiranë në Nëntor 2012.

d) *Procedura të ndryshme doganore midis Shqipërisë dhe Kosovës, përfshirë numrin e dokumenteve të kërkuara për eksport – import*. Ky numër është mbi mesataren e vendeve të CEFTA dhe nuk është siguruar plotësisht dorëzimi i tyre elektronikisht. Të dy administratat doganore duhet të inkurajohen që të vazhdojnë punën e filluar shtatorin e 2012, për integrimin gradual të dy sistemeve elektronike doganore. Dogana shqiptare dhe kosovare shfrytëzojnë një softuer identik të quajtur ASYCUDA, i cili mundëson shkëmbimin e informacionit para se malli të arrijë në kufi dhe me këtë mundëson, kalimin më të shpejtë të kufirit.

Sipas *Huruglicës*, megjithëse është investuar shumë në të dy anët e kufirit në ndërtimin e autostradës, gjendja e infrastrukturës në pikën e kalimit kufitar Morinë/Vërmicë është larg ideale. Për shkak të mungesës së korsive të mjaftueshme dhe vendeve për ndalimin e kamionëve, shpeshherë në kufi shihen kolona të gjata të kamionëve duke pritur në kufirin mes dy vendeve. Raporte të ndryshme përfshirë atë të Bankës Botërore “Doing Business”, vlerësojnë rëndësinë e infrastrukturës së duhur në kufi. Duhet që dy Qeveritë të ndajnë fonde për zgjerimin e hyrjeve-daljeve si dhe ngritjen e një infrastrukture më të mirë në këtë pikë kufitare.

e) *Mungesa e kushteve optimale për kryerjen e veprimeve doganore në disa terminale*. Në 1 Gusht 2013 të gjitha automjetet transportuese të mallrave nga Shqipëria duhet të ndryshonin destinacionin drejt terminalit doganor privat në qytetin e Prizrenit, Ferizajt apo Prishtinës ku duhet të kryenin veprimet doganore (zhdoganime etj.). Kjo porcedure shkaktonte humbje kohe për dërgimin e mallrave në destinacionin final, dhe rritje të kostove direkte të transportit. Gjithashtu, mungesa e kushteve për kryerjen e veprimeve doganore në këtë terminal përbënte një tjetër kosto shtesë për operatorët eksportues.

Me insistimin e fuqishëm të biznesit në të dy anët e kufirit dhe me vullnetin e qeverive situata u zgjidh, por pyetja qëndron a mund të ishte shmangur ky shqetësim? A mundet Kosova dhe Shqipëria të eliminojnë barrierat tregtare midis tyre? C’farë mund të bëhet për të penguar lindjen e pengesave jo-tarifore?

f) *lidhjet e munguara afariste mes dy vendeve*. Hashani ngre një problematike origjinale e cila duhet të kapërcehet për të rritur përfitimet e një bashkimi doganor: marrëdhëniet relativisht të ulëta mes afaristeve të dy vendeve. Aktualisht afaristët e të dyja vendeve i kanë të konsoliduara marrëdhëniet me afaristët e shteteve tjera, dhe krijimi i relacioneve të reja bartë një nivel të caktuar rreziku si dhe përcillet me kosto të parikuperueshme. Për pasojë, afaristët hezitojnë t’i futen përpjekjeve të tilla. Kjo pikë kërkon ndihmën e institucioneve dhe shoqatave të biznesit që të lehtësojnë bashkëpunimin dhe që pasiguria dhe asimetria e informatave në këtë proces të absorbohet nga këto institucione.

Siç paraqet *Gribizi*, projekti i Logjistikës Tregtare të Ballkanit Perëndimor, një ndër shumë përpjekjet rajonale për fuqizimin e bashkëpunimit rajonal po mbështet të gjitha vendet e rajonit për reduktimin e kostove të transaksioneve tregtare. Ky projekt synon të zvogëlojë pengesat rregullatore dhe administrative për tregtinë ndërkufitare në rajon, përmes procedurave më të efektshme të eksportit, importit dhe tranzitit; të nxisë një bashkëpunim më të ngushtë dhe më të harmonizuar midis agjencive kombëtare dhe midis vendeve; dhe inkurajimin e përdorimit më të gjerë të sistemeve elektronike për shkëmbimin e të dhënave, të numrit të kontrolleve me bazë risku; dhe pagesat e lidhura me logjistikën tregtare.

Sa i takon kontributit të këtij projekti në tregtinë Shqipëri/Kosovë mund të citohet: Marrëveshja e Tranzitit, bazuar në gatishmërinë dhe vullnetin e shprehur nga vendet për bashkëpunim në transportin e mallrave midis Shqipërisë dhe Kosovës, ka organizuar, lehtësuar dhe moderuar tre takime të nivelit teknik të përbashkët midis Doganave të Shqipërisë dhe Kosovës, Autoritetit të Ushqimit Kombëtar Shqiptar dhe Agjencisë Veterinare dhe të Ushqimit Kosovar në harkun kohor nëntor 2012- maj 2013. Këto takime kanë për qëllim gjetjen e gjuhës së përbashkët mes të gjitha palëve dhe arritjen e një marrëveshje mbi masat e nevojshme për të lehtësuar kalimin e mallrave që vijnë në portin e Durrësit në Shqipëri dhe janë të destinuara për në Kosovë. Nënshkrimi i një marrëveshje transporti dypalëshe pritet për në fund të 2013 (*Gribizi*).

## 7. Bashkimi Doganor, përfitime dhe kosto

*Hackaj* përmbledh avantazhet e një Bashkimi Doganor mes Shqipërisë dhe Kosovës në listën e mëposhtme (i) nxit / krijon flukset tregtare mes vendeve anëtare; (ii) mbron prodhuesit vendore përmes një tarife doganore të përbashkët; (iii) rrit fuqinë e negocimit me të tretet; (iv) eventualisht kontribuon me të ardhura doganore shtese tek vendet anëtare që kanë aktivitet tregtar me të ulet; (v) duke rritur konkurrencën mes prodhuesve vendore, specializon vendet në prodhimet me eficiente; (vi) frenon monopolet vendore – është më e vështirë për to të llobojnë dy ose më shumë qeveri, se sa një qeveri kombëtare të vetme; (vii) tenton të konvergjoje rrogat, çmimet, shkallen e profitit, normat e interesit brenda vendeve anëtare; (viii) eliminon kontrollin doganor në kufijtë e brendshëm (që kryhet kryesisht për të respektuar Rregullat e Origjinës, normat fito-sanitare, etj); (ix) tarifa Doganore e Përbashkët është më e thjeshtë, mënjanon shtrembërimet e koston të lendeve të para, etj; (x) eliminon komplikimet administrative të verifikimit të Rregullave të Origjinës në kufijtë e brendshëm; dhe (xi) zmadhon tregun, si për prodhuesit e brendshëm ashtu dhe për investitorët e huaj.

Ndërkohë *Zogaj* mbështet avancimin drejt bashkimit doganor duke avancuar efektet e pritura pozitive në rritjen e vëllimit të tregtisë bilaterale, dhe si hap të mëtejshëm drejt një bashkimi politik. Por koston e kësaj sipërmarrjeje për *Zogaj* dhe *Rexhepi*, qëndrojnë kryesisht tek mekanizmi i shpërndarjes së të ardhurave doganore, për më tepër që Kosova merr një pjesë të madhe të hyrave të buxhetit nga doganat. Kusht për suksesin e kësaj iniciative është besimi reciprok, krijimi i institucioneve të përbashkëta dhe marrëveshjet me Bashkimin Evropian.

Ndërtimi i institucioneve të përbashkëta është dhe teza që mbështet *Xhepa*. Mund të filloje nga Doganat por do të duhet të shtrihet përtej shkëmbimeve thjesht tregtare. Në këtë qasje, “...tashmë është koha që ekipe të përbashkëta ekspertësh të politikave publike, të punojnë me një program të miratuar nga qeveritë përkatëse, në mënyrë që të vendosen prioritetet dhe axhenda kohore e këtij procesi harmonizues. Në këtë mënyrë, krijohet një shtrat institucional e ligjor që do të mundësojë sipërmarrjen private në të dy anët e kufirit të zhvillojë projekte investimesh dhe të krijojnë punësim në të dy vendet tona” përfundon kontribuesi.

*Rexhepi* vë theksin tek nevoja për studim fizibiliteti mbi përparësitë dhe detyrimet që rrjedhin nga një bashkim doganor mes dy vendeve. Për më tepër, bashkimi doganor do të kërkonte kohë dhe mund për harmonizimin e legjislacionit dhe të standardeve, si edhe një “po”, qoftë edhe të heshtur nga Komisioni Evropian, për shkak se Shqipëria është në proces të anëtarësimit në BE, ndërsa Kosova sapo ka hyrë në procesin asociimit dhe të anëtarësimit. Në rastin e Bashkimit Doganor të Shqipërisë me Kosovën, janë politikanet, kryesisht ata nga Shqipëria, që po insistojnë drejt një integrimi me të madh të dy ekonomive (i.e. fjalimi i Ramës në Parlamentin

Kosovar, fjala e Ministrit Ahmetaj ne Konferencën e organizuar nga Konrad Adenaur Stiftung mbi BENELUX-in Ballkanik, etj).

*Kursani në analizon strukturën prodhuese te çdo vendi dhe mënyrat e përfitimit nga krijimi i një tregu te përbashkët. Rezultati i tij është i thjeshte dhe i qarte: integrimi me i thelle ekonomik mes dy vendeve mund te prodhoje rezultate nen-optimale n.q.s. nuk merren parasysh veçoritë ekonomike te cdo vendi partner. "...pa rritjen e prodhimit në sektorët ekzistues prodhuese, dhe pa filluar prodhimin në sektorë të ri, apo krijimin e çfarëdo rrethana që vë theks avantazhet krahasuese të të dyja vendeve, bashkimi doganor vetëm se do t'ia lehtësoj qarkullimin e mallrave vendeve të treta brenda territorit doganor të krijuar, siç ishte rasti me efektet e autostradës".*

Duke pasur parasysh problemet aktuale ne implementimin e marrëveshjes ekzistuese te CEFTA dhe strukturën prodhuese te Kosovës dhe Shqipërisë, *Hackaj* sugjeron një qasje me graduale drejt një bashkimi doganor. Ne këtë skenar do te synohej zhdukja a pengesave jo-tarifore mes dy vendeve, por duke ruajtur një shkalle pavarësie kombëtare te politikave tregtare dhe te taksimit. Kjo kërkon eliminimin gradual te Rregullave te Origjinës mes dy vendeve dhe vendosjen graduale te një tarife te përbashkët doganore. Kjo do te shoqërohej me ndërtimin dhe administrimin e një administrate doganore te përbashkët. Me konkretisht, autori përmbledh hapat drejt një Bashkimi Doganor mes Kosovës dhe Shqipërisë, si më poshtë:

- Marrja e vendimeve politike detyruese përkatëse nga të dy Qeveritë;
- Ngritja e grupeve të punës për identifikimin dhe vlerësimin e Rregullave të Origjinës dhe për vendosjen e Tarifës se Përbashkët Doganore në të dy vendet;
- Vendosja e sistemit te shpërndarjes se te ardhurave te ngritura nga përdorimi tarifës së përbashkët doganore
- Ngritja dhe funksionimi i një administrate të përbashkët për te monitoruar progresin;
- Përgatitja e procedurave mbi produktet që do të përjashtohen nga BD;
- Vendosja e një Kodi Doganor Uniform mes dy vendeve;
- Njësimi i procedurave administrative dhe të sistemeve të informacionit;

## **8. Bashkërendim politikash ne vend te Bashkërendimit Politik**

Intensifikimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dypalësh me politika ekonomike të përbashkëta në sektorë të caktuar, është konsideruar nga Curiaweb më optimal se sa një bashkërendim politik i imponuar nga lart poshtë që do te kërkonte një strukturë administrative komplekse dhe burime financiare të qënësishme. Gjithashtu, kjo e dyta mund të krijojë edhe prishje të panevojshme të ekuilibrave politikë në rajon, qe jane të domosdoshëm në proceset integruese të të dyja vendeve.

Bashkërendimi dhe koordinimi i politikave të caktuara mes Shqipërisë dhe Kosovës, do të shtynte më tej bashkëpunimin ekonomik të arritur në një Bashkim Doganor, duke vazhduar me konvergencën e disa sektorëve strategjike mes dy vendeve. *Xhepa* përmend "...harmonizimin e legjislacioneve te investimeve, të tregut të punës, të politikave fiskale e tatimore, të konkurrencës". Meidani ve theksin tek "...bashkëveprimi legjislativ e ekzekutiv, dhe, mbi të gjitha, ndërvëprimi midis parlamenteve, dikastereve, institucioneve të pavarura, p.sh. gjykatave e prokurorive, përfshirë dhe gjykatat kushtetuese, i strukturave "ndërmjetëse";... realizimi i projekteve të ndryshme infrastrukture, sidomos i korridoreve të transportit, me bashkim kapitalesh dhe ekspertize... veprimtaritë e përbashkëta akademike, projektet kërkimore-shkencore ..., etj."

Ndër iniciativat e para të përbashkëta dhe politikat sektoriale strategjike ku bashkërendimi dhe konvergjenca do të përktheheshin në një proces vendim-marrje unik, më të përmendurat në Curiaweb janë vlerësimi i mundësive prodhuese dhe i kërkesës, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, me qëllim zëvendësimin e importeve nga vendet e treta. Pothuaj të gjithë kontribuesit insistojnë në aktivitete hulumtimi të dy tregjeve dhe të potencialeve qe ato ofrojnë.

Vendin kryesor mes propozimeve për bashkërendim e zë politika energjetike, e fokusuar në investime të përbashkëta, prodhimin, transmetimin, depozitimin, prokurimin dhe shkëmbimin e energjisë (elektrike / hidrokarbure). Ndërsa *Hashani, Rexhepi, Preci, Civiçi E, Sokoli, Xhepa* etj.

theksojnë nevojën e bashkëpunimit politik dhe ekonomik në këtë sektor, *Bello* zberthen detajet e një bashkëpunimi të tillë në funksion të përfitimeve, strukturave të funksionimit nacionale dhe kostove të nevojshme për të realizuar këtë bashkëpunim. Së fundmi, ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kilovoltësh Kosovë - Shqipëri fillimisht rrit mundësinë e shkëmbimit të energjisë elektrike, krijon rrethana për harmonizimin më të mirë të politikave energjetike, si dhe eliminon situatën e pafavorshme të lidhjes së sistemeve të të dyja vendeve (Kosova ka lidhje 400 kilovolt me të gjitha shtetet fqinje, pos me Shqipërinë ku lidhja është 220 kilovolt).

Vijojnë një sërë politikash të tjera interesante për bashkëpunim si: (i) politikave të mbrojtjes së konsumatorit, nëpërmjet harmonizimit, unifikimit dhe njohjes reciproke të kompetencave të organeve nacionale, procedurave, rregulloreve dhe teknologjive të përdorura në secilin vend; (ii) politikave të turizmit përmes harmonizimit të ofertës dhe produkteve turistike cilësore për t'u bërë një pol i rëndësishëm turistik rajonal; (iii) hartimin dhe implementimin e politikave të përbashkëta për përmirësimin e klimës së biznesit dhe stimulimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme duke theksuar nxitjen e bashkëpunimit të dhomave të tregtisë dhe industrisë & koordinimin e biznesit privat; (iv) koordinimin e strategjive në sektorët e bankës, financës dhe ndërmjetësimit financiar (përfshirë dhe sigurimet) ku një rol të rëndësishëm do të luanin dhe autoritetet rregullatore nacionale dhe Bankat Qendrore respektive; (v) koordinimin ligjor e institucional për luftimin e krimit financiar & ekonomik, pastrimin e parave, eliminimin apo zbulimin e transaksioneve apo pagesave jolegale; (vi) unifikimin e rregullave të prokurimit publik, të legjislativës mbi bizneset; (vii) luftimi i monopoleve dhe inkurajimi i Ndërmarrjeve të Mesme dhe të Vogla, etj.; për të përfunduar me (viii) koordinimin e politikave makroekonomike, fiskale e buxhetore për të krijuar një zonë ekonomiko-financiare të përbashkët të stabilizuar e larg krizave, me qëllim eliminimin gradual të diferencave tatimore dhe të taksave dhe aseteve të tyre.

Si përfundim duke parë kostot dhe përfitimet, kontribuesit i mëshojnë me tepër koordinimit të politikave dhe iniciativave ekzistuese se sa koordinimit politik.

- fund -